




Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Priufljeno Mir/Dana 31-05-2024			
Nr. i organit Org. broj	Numri i Droj	Shitja e Prilog	Vlera Mëdha e
01-	110/05-	834	



Komuna e Vitisë  
Opština Vitina  
Municipality Viti/na

Kuvendi i Komunës së Vitisë, në bazë të nenit 12, shkronja d të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17, pika 2, lidhur me neni 6, paragrafi I, pika 1.1, të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019), nenit 36, paragrafi 36.2, shkronja d, neni 40, 41, shkronja a të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 29.05.2024 miraton këtë:

## V E N D I M

**për formimin e komisionit vlerësues dhe zbatimin e procedurave për dhënie e pronës paluajtshme të komunës tek shtëpia e kulturës "Gursel e Bajram Sylejmani" në shfrytëzim afatëshkurt prej 13 viteve**

**I.** Me këtë Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për formimin e komisionit për vlerësimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës së Vitise. Komisioni propozohet prej 5 anëtarëve, dy nga ekzekutivi, dy kuvendi i komunës dhe një nga shoqëria civile.

1. Albulena Haxhiu, anëtare e komisionit (përfaqësuese e ekzekutivit të komunës);
2. Driton Halabaku, anëtar i komisionit (përfaqësues i ekzekutivit të komunës);
3. Nezir Musliu, anëtar i komisionit (përfaqësues i kuvendit të komunës);
4. Jakup Demiri anëtar i komisionit (përfaqësues i kuvendit të komunës);
5. Shkurte Bardhi (përfaqësues i sektorit joqeveritar).

**II.** Me këtë vendim detyrat e komisionit nga neni I i këtij vendimi janë përcaktuar në Ligjin për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 i Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës me Nr.10, të datës 03.04.2019). Komisioni vlerësues udhëheq me procedurat mbi dhënie e pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim, përgatit kriteret e ankandit, përcakton çmimin fillestar, zgjedhet kryetari i komisionit, vlerëson ofertat.

**III.** Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i Komunës së Vitisë, anëtarët e komisionit, drejtoritë përgjegjëse të Komunës së Vitisë.

**IV.** Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 8, lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Anëtarëve të komisionit
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I  
Bekim Azizi

